

# STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 550

## PALËT E LIDHURA

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

### PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
<b>Hyrje</b>	
Objekti i këtij SNA-je	1
Natyra e Marrëdhënieve dhe Transaksioneve të Palëve të Lidhura	2
Përgjegjësitë e Audituesit	3-7
Hyrja në fuqi	8
<b>Objektivat</b>	9
<b>Përkufizimet</b>	10
<b>Kërkesat</b>	
Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Veprimtaritë Përkatëse	
Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalive Materiale që Shoqërojnë Marrëdhëniet dhe Transaksionet e Palëve të Lidhura	11-17
Përgjigja ndaj Rreziqeve të Anomalive Materiale që Shoqërojnë Marrëdhëniet dhe Transaksionet e Palëve të Lidhura	18-19
Vlerësimi i Kontabilizimit dhe Raportimit të Marrëdhënieve dhe Transaksioneve të Palëve të Lidhura të Identifikuara	20-24
Deklarimet me shkrim	25
Komunikimi me Ata që Janë Ngarkuar me Qeverisjen	26
Dokumentimi	27
<b>Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese</b>	
Përgjegjësitë e Audituesit	A1-A3
Përkufizimi i Palës së Lidhur	A4-A7
Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Veprimtaritë Përkatëse	A8-A28
Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalive Materiale që Shoqërojnë Marrëdhëniet dhe Transaksionet e Palëve të Lidhura	A29-A30
Përgjigja ndaj Rreziqeve të Anomalive Materiale që Shoqërojnë Marrëdhëniet dhe Transaksionet e Palëve të Lidhura	A31-A45
Vlerësimi i Kontabilizimit dhe Raportimit të Marrëdhënieve dhe Transaksioneve të Palëve të Lidhura të Identifikuara	A46- A47
Deklarimet me Shkrim	A48-A49
Komunikimi me Ata që Janë Ngarkuar me Qeverisjen	A50

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 550, "Palët e Lidhura" duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 "Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit".

## Hyrje

### Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësitë e audituesit që kanë të bëjnë me marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura në auditimin e pasqyrave financiare. Në mënyrë të veçantë, ai jep shpjegime të zgjeruara se si zbatohen SNA 315 (i rishikuar),<sup>1</sup> SNA 330,<sup>2</sup> dhe SNA 240<sup>3</sup> në lidhje me rreziqet për anomali materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura.

### Natyra e Marrëdhënieve dhe Transaksioneve të Palëve të Lidhura

2. Shumica e transaksioneve të palëve të lidhura kryhen në rrjedhën normale të biznesit. Në këto rrethana, ato nuk bartin ndonjë rrezik më të lartë për anomali materiale në pasqyrat financiare se sa transaksionet e ngjashme me palët e palidhura. Megjithatë, natyra e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura, në disa rrethana, mund të shkaktojë rreziqe më të larta për anomali materiale në pasqyrat financiare se sa transaksionet me palët e palidhura. Për shembull:
  - (a) Palët e lidhura mund të operojnë nëpërmjet një game të marrëdhënieve dhe strukturave tepër të gjera dhe komplekse, me një kompleksitet korespondues në rritje të transaksioneve të palëve të lidhura.
  - (b) Sistemet e informacionit mund të mos jenë efektive në identifikimin apo në mbledhjen e transaksioneve dhe të tepricave gjendje mes entitetit dhe palëve të lidhura me të.
  - (c) Transaksionet e palëve të lidhura mund të mos kryhen sipas kushteve dhe afateve normale të tregut; për shembull, disa transaksione të palëve të lidhura mund të kryhen pa dhënë gjë në këmbim.

### Përgjegjësitë e Audituesit

3. Për arsyen se palët e lidhura nuk janë të pavarura nga njëra tjetra, shumica e kuadrove të raportimit financiar përcaktojnë kërkesa të veçanta të kontabilizimit dhe të dhënies së informacionit shtesë për marrëdhëniet, transaksionet dhe tepricat e llogarive të palëve të lidhura për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë natyrën e tyre dhe efektet aktuale apo potenciale në pasqyrat financiare. Kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton të tilla kërkesa, audituesi ka përgjegjësinë të kryejë procedurat e auditimit për të identifikuar, vlerësuar dhe përgjigjur ndaj rreziqeve për anomali materiale që vijnë nga mos arritja e entitetit për të kontabilizuar apo dhënë

<sup>1</sup> SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij*.

<sup>2</sup> SNA 330, *Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara*.

<sup>3</sup> SNA 240, *Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Mashtrimin në Auditimin e Pasqyrave Financiare*.

informacionin e marrëdhënieve, transaksioneve apo tepricave të llogarive me palët e lidhura në përputhje me kërkesat e kuadrit.

- Edhe kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton një minimum kërkesash ose nuk përcakton kërkesa fare për palët e lidhura, megjithatë audituesi duhet të marrë njohuri për marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura me entitetin, të mjaftueshme për të konkluduar nëse pasqyrat financiare, për aq sa ato mund të jenë ndikuar nga këto marrëdhënie dhe transaksione: (Ref: Para. A1)

(a) Arrijnë paraqitjen e drejtë (për kuadrot e paraqitjes së drejtë); ose (Ref: Para. A2)

(b) Nuk janë keqrrëfyese (për kuadrot e përputhshmërisë). (Ref: Para. A3)

- Më tej, njohja e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura të entitetit është e rëndësishme për vlerësimin e audituesit nëse janë të pranishme apo jo një ose më shumë faktorë të rrezikut për mashtrime siç kërkohet nga SNA 240,<sup>4</sup> për arsyen se mashtrimi mund të kryhet më lehtë nëpërmjet palëve të lidhura.
- Për shkak të kufizimeve të vetvetishme të auditimit, ka një rrezik të pashmangshëm që të mos zbulohen disa anomali materiale në pasqyrat financiare, edhe kur auditimi është planifikuar dhe kryer në përputhje me SNA-të.<sup>5</sup> Në kontekstin e palëve të lidhura, efektet potenciale të kufizimeve të vetvetishme në aftësitë e audituesit për të zbuluar anomalitë materiale janë më të mëdha për arsyet e mëposhtme:
  - Drejtimi mund të mos ketë dijeni për ekzistencën e të gjitha marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura, veçanërisht në qoftë se kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar nuk përcakton kërkesa për palët e lidhura.
  - Marrëdhëniet e palëve të lidhura mund të paraqesin një mundësi më të madhe për marrëveshje të fshehta, për fshehje ose për manipulimin nga drejtimi.
- Planifikimi dhe kryerja e auditimit me skepticizëm profesional siç kërkohet nga SNA 200<sup>6</sup> është veçanërisht e rëndësishme në këtë kontekst, duke patur parasysh mundësitë për mosdeklarimin e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura. Kërkesat në këtë SNA janë përgatitur për të ndihmuar audituesin që të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet për anomali materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura dhe për të hartuar procedura auditimi që u përgjigjen rreziqeve të vlerësuara.

---

<sup>4</sup> SNA 240, paragrafi 25.

<sup>5</sup> SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi A53-A54.

<sup>6</sup> SNA 200, paragrafi 15.

**Hyrja në Fuqi**

8. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

**Objektivat**

9. Objektivat e audituesit janë:

- (a) Pavarësisht nga fakti nëse kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton kërkesa apo jo për palët e lidhura, për të marrë njohuri për marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura të mjaftueshme për të qënë i aftë:
- a. Të njohë faktorët e rrezikut për mashtrim, në qoftë se ka të tillë, që vijnë nga marrëdhëniet dhe transaksionet me palët e lidhura të cilat janë përkatëse për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale për shkak të mashtrimit; dhe
  - b. Të konkludojë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse pasqyrat financiare, për aq sa ato janë ndikuar nga këto marrëdhënie dhe transaksione:
    - i. Arrijnë paraqitjen e drejtë (për kuadrot e paraqitjes së drejtë); ose
    - ii. Nuk janë keqrrëfyese (për kuadrot e përputhshmërisë); dhe
- (b) Më tej, kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton kërkesa për palët e lidhura, të marrë evidencën e nevojshme të auditimit rreth marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura dhe nëse ato janë identifikuar, kontabilizuar dhe raportuar përkatësisht në pasqyrat financiare në përputhje me kuadrin.

**Përkufizimet**

10. Për qëllimet e SNA-ve, termat e mëposhtëm kanë kuptimin që ju është dhënë në vijim:
- (a) Transaksion duarlibër – Transaksioni i kryer në kushtet kur një blerës dhe shitës të vullnetshëm, të cilët nuk janë të lidhur, veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri dhe ndjekin interesat e tyre më të mira.
  - (b) Palë e lidhur – Një palë që është, qoftë: (Ref: Para. A4-A7)
    - i. Një palë e lidhur siç përkufizohet në kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar; ose
    - ii. Kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton një minimum kërkesash ose nuk ka fare kërkesa për palët e lidhura:

- a. Një person ose ndonjë entitet tjetër që ka kontrollin ose influencë të konsiderueshme, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetësish, ndaj entitetit raportues;
- b. Entiteti tjetër ndaj të cilit entiteti raportues ka kontrollin apo influencë të konsiderueshme, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nëpërmjet një apo më shumë ndërmjetësish; ose
- c. Entiteti tjetër që është nën kontroll të përbashkët me entitetin raportues nëpërmjet:
  - i. Kontrollit të përbashkët të pronësisë;
  - ii. Pronarëve të cilët janë pjesarë të afërt të familjes; ose
  - iii. Drejtimi kryesor i përbashkët.

Megjithatë, entitetet që janë nën kontrollin e përbashkët nga shteti (i cili është, pjesë e qeverisjes kombëtare, rajonale apo vendore) nuk konsiderohen të lidhura përveç rastit kur ato janë angazhuar në transaksione të konsiderueshme ose ndajnë burimet në masë të konsiderueshme me njëri tjetrin.

## **Kërkesat**

### **Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Veprimtaritë Përkatëse**

11. Si pjesë e procedurave të vlerësimit të rrezikut dhe veprimtarive përkatëse që SNA 315 (i rishikuar) dhe SNA 240 kërkojnë që të kryejë audituesi gjatë auditimit,<sup>7</sup> audituesi duhet të kryejë procedurat e auditimit dhe veprimtaritë përkatëse që parashikohen në paragrafët 12-17 për të marrë informacione të përshtatshme për të identifikuar rreziqet e anomalisë materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura. (Ref: Para. A8)

#### *Njohja e Marrëdhënieve dhe Transaksioneve të Palëve të Lidhura të Entitetit*

12. Diskutimet në ekipin e angazhimit të cilat kërkohen nga SNA 315 (i rishikuar) dhe SNA 240<sup>8</sup> përfshijnë konsiderata të veçanta për ndjeshmërinë e pasqyrave financiare ndaj anomalive materiale që vijnë nga mashtrimi apo gabimi me prejardhje nga marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura të entitetit. (Ref: Para. A9-A10)

13. Audituesi duhet të pyesë drejtimin në lidhje me:

---

<sup>7</sup> SNA 315 (i rishikuar), paragrafi 5; SNA 240, paragrafi 17.

<sup>8</sup> SNA 315 (i rishikuar), paragrafi 10; SNA 240, paragrafi 16.

- (a) Identitetin e palëve të lidhura të entitetit, përfshirë ndryshimet nga periudha e mëparshme; (Ref: Para. A11-A14)
  - (b) Natyrën e marrëdhënieve mes entitetit dhe këtyre palëve të lidhura; dhe
  - (c) Nëse entiteti është angazhuar në ndonjë transaksion me këto palë të lidhura gjatë periudhës dhe, në qoftë se është kështu, llojin dhe qëllimin e transaksioneve.
14. Audituesi pyet drejtimin dhe të tjerë brenda entitetit dhe kryen procedura të tjera të vlerësimit të rrezikut që konsiderohen të përshtatshme, për të marrë njohuri për kontrollet, nëse ka të tilla, që ka vendosur drejtimi për të: (Ref: Para. A15-A20)
- (a) Identifikuar, kontabilizuar dhe raportuar marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar;
  - (b) Autorizuar dhe miratuar transaksionet dhe angazhimet e rëndësishme me palët e treta; dhe (Ref: Para. A21)
  - (c) Autorizuar dhe miratuar transaksionet dhe angazhimet e rëndësishme me palët e treta jashtë rrjedhës normale të biznesit.

*Ruajtja e Vigjilencës për Informacione të Palëve të Lidhura Kur Rishikohen Rregjistrimet apo Dokumentet*

15. Gjatë auditimit, audituesi mbetet vigjilent, kur inspekton rregjistrimet apo dokumentet, për angazhime apo informacione të tjera që mund të tregojnë ekzistencën e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura të cilat drejtimi nuk i ka identifikuar apo raportuar më parë tek audituesi. (Ref: Para. A22-A23)

Kryesisht, audituesi inspekton sa më poshtë për tregues të ekzistencës të marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura të cilat drejtimi nuk i ka identifikuar apo raportuar më parë tek audituesi:

- (a) Konfirmime të bankës dhe ligjore të marra si pjesë e procedurave të audituesit;
  - (b) Proces-verbalet e mbledhjeve të aksionerëve dhe atyre që janë ngarkuar me qeverisjen; dhe
  - (c) Ato rregjistrime apo dokumenta të tjera që audituesi i konsideron të nevojshme në rrethanat e entitetit.
16. Në qoftë se audituesi identifikon transaksione të rëndësishme jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit kur kryen procedurat e kërkuara të auditimit nga paragrafi 15 ose nëpërmjet procedurave të tjera të auditimit, audituesi pyet drejtimin rreth: (Ref: Para. A24-A25)

- (a) Natyrës së këtyre transaksioneve; dhe (Ref: Para. A26)
- (b) Nëse janë përfshirë apo jo palët e lidhura. (Ref: Para. A27)

*Shkëmbimi i Informacionit të Palëve të Lidhura mes Ekipit të Angazhimit*

17. Audituesi shkëmben informacionin përkatës të marrë rreth palëve të lidhura të entitetit me pjestarët e tjerë të ekipit të angazhimit. (Ref: Para. A28)

**Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalive Materiale që Shoqërojnë Marrëdhëniet dhe Transaksionet e Palëve të Lidhura**

18. Për të plotësuar kërkesat e SNA 315 (i rishikuar) për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e anomalive materiale,<sup>9</sup> audituesi identifikon dhe vlerëson rreziqet e anomalive materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura dhe përcakton nëse ndonjë nga këto rreziqe janë rreziqe të konsiderueshme apo jo. Për ta bërë këtë përcaktim, audituesi trajton transaksionet e konsiderueshme të palëve të lidhura të identifikuar jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit sikur ato shkaktojnë rreziqe të konsiderueshme.

19. Në qoftë se audituesi identifikon faktorë të rrezikut të mashtrimit (përfshirë rrethanat që lidhen me ekzistencën e palëve të lidhura me influencë dominuese) kur kryen procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe veprimtaritë përkatëse në lidhje me palët e lidhura, audituesi merr në konsideratë këto informacione në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale për shkak të mashtrimit në përputhje me SNA 240. (Ref: Para. A6, A29-A30)

**Përgjigja ndaj Rreziqeve të Anomalive Materiale që Shoqërojnë Marrëdhëniet dhe Transaksionet e Palëve të Lidhura**

20. Si pjesë e kërkesave të SNA 330 që audituesi t'i përgjigjet rreziqeve të vlerësuar,<sup>10</sup> audituesi përgatit dhe kryen procedura të mëtejshme të auditimit për të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme rreth rreziqeve të anomalive materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura. Këto procedura auditimi përfshijnë ato që kërkohen nga paragrafët 21-24. (Ref: Para. A31-A34)

*Identifikimi i Palëve të Lidhura të Pidentifikuara ose të Paraportuara apo të Transaksioneve të Konsiderueshme të Palëve të Lidhura*

21. Në qoftë se audituesi identifikon angazhime ose informacione që sygjerojnë ekzistencën e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura të cilat drejtimi nuk i ka identifikuar apo raportuar më parë tek audituesi, audituesi përcakton nëse rrethanat mbështetëse konfirmojnë ekzistencën e këtyre marrëdhënieve ose transaksioneve.

<sup>9</sup> SNA 315 (i rishikuar), paragrafi 25.

<sup>10</sup> SNA 300, paragrafët 5-6.

22. Në qoftë se audituesi identifikon palë të lidhura ose transaksione të konsiderueshme të palëve të lidhura të cilat drejtimi nuk i ka identifikuar apo raportuar më parë tek audituesi, audituesi duhet:

- (a) Menjëherë të komunikojë informacionin përkatës tek pjestarët e tjerë të ekipit të angazhimit; (Ref: Para. A35)
- (b) Kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton kërkesa për palët e lidhura:
  - i. Kërkon nga drejtimi të identifikojë të gjitha transaksionet me palën e lidhur të sapo identifikuar për vlerësim të mëtejshëm të audituesit; dhe
  - ii. Pyet se përse kontrollet e entitetit nuk kanë arritur të identifikojnë apo raportojnë mbi marrëdhëniet dhe transaksionet e palës së lidhur;
- (c) Kryen procedurat thelbësore përkatëse të auditimit që lidhen me këtë palë të lidhur të sapo identifikuar ose transaksionet e konsiderueshme të palës së lidhur; (Ref: Para. A36)
- (d) Rimerr në konsideratë rrezikun se mund të ekzistojnë palë të tjera të lidhura ose transaksione të tjera të konsiderueshme të palëve të lidhura të cilat drejtimi nuk i ka identifikuar apo raportuar më parë tek audituesi dhe kryen procedura auditimi shtesë sipas nevojës; dhe
- (e) Në qoftë se mosraportimi nga drejtimi duket i qëllimshëm (dhe për këtë tregon rrezikun e anomalive materiale për shkak të mashtrimit), vlerëson implikimet për auditimin. (Ref: Para. A37)

*Identifikimi i Transaksioneve të Konsiderueshme të Palëve të Lidhura Jashtë Rrjedhës Normale të Biznesit të Entitetit*

23. Për të identifikuar transaksionet e konsiderueshme të palëve të lidhura jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit, audituesi:

- (a) Inspekton kontratat apo marrëveshjet mbështetëse, nëse ka të tilla, si dhe vlerëson nëse:
  - (i) Llogjika e biznesit për transaksionet (ose mungesa e tij) tregon se ato janë kryer për t'u angazhuar në raportim financiar mashtrues apo për të fshehur keqpërdorimin e aktiveve;<sup>11</sup> (Ref: Para. A38-A39)
  - (ii) Kushtet e transaksioneve janë të njëjta me shpjegimet e drejtitimit; dhe

<sup>11</sup> SNA 240, paragrafi 33(c).



- (iii) Transaksionet janë kontabilizuar siç duhet dhe janë raportuar në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar; dhe

(b) Merr evidencë auditimi që transaksionet janë autorizuar dhe miratuar siç duhet. (Ref: Para. A40-A41)

*Pohimet se Transaksionet e Palëve të Lidhura Janë Kryer me Kushtet e Njëjta me Ato Mbizotëruese në një Transaksion Duarlirë*

24. Në qoftë se drejtimi ka bërë pohimin në pasqyrat financiare për efektin që transaksioni i palës së lidhur është kryer me kushtet e njëjta me atë që mbizotërojnë në një transaksion duarlirë, audituesi merr evidencë auditimi të nevojshme rreth pohimit. (Ref: Para. A42-A45)

### **Vlerësimi i Kontabilizimit dhe Raportimit të Marrëdhënieve dhe Transaksioneve të Palëve të Lidhura të Identifikuara**

25. Për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare në përputhje me SNA 700 (i rishikuar),<sup>12</sup> audituesi vlerëson: (Ref: Para. A46)

(a) Nëse marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura të identifikuara janë kontabilizuar dhe raportuar siç duhet në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar; (Ref: Para. A47)

(b) Nëse efektet e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura:

- (i) Pengojnë që pasqyrat financiare të arrijnë paraqitjen e drejtë (për kuadrot e paraqitjes së drejtë); ose
- (ii) Shkaktojnë që pasqyrat financiare të jenë keqrrëfyese (për kuadrot e përputhshmërisë).

### **Deklarimet me Shkrim**

26. Kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton kërkesa për palët e lidhura, audituesi merr deklarime me shkrim nga drejtimi dhe, kur është e nevojshme, nga ata që janë ngarkuar me qeverisjen, që: (Ref: Para. A48-A49)

(a) Ata kanë raportuar tek audituesi identitetin e palëve të lidhura të entitetit dhe të gjitha marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura për të cilat ata kanë dijeni; dhe

---

<sup>12</sup> SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*, paragrafët 10-15.

- (b) Ata kanë kontabilizuar dhe raportuar këto marrëdhënie dhe transaksione në përputhje me kërkesat e kuadrit.

### **Komunikimi me Ata që Janë Ngarkuar me Qeverisjen**

27. Përveç rastit kur të gjithë ata që janë ngarkuar me qeverisjen janë përfshirë në drejtimin e entitetit,<sup>13</sup> audituesi komunikon me ata që janë ngarkuar me qeverisjen çështjet e rëndësishme që dalin gjatë auditimit në lidhje me palët e lidhura të entitetit. (Ref: Para. A50)

### **Dokumentimi**

28. Audituesi përfshin në dokumentacionin e auditimit emrat e palëve të lidhura dhe natyrën e marrëdhënieve të palëve të lidhura.<sup>14</sup>

\* \* \*

### **Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese**

#### **Përgjegjësitë e Audituesit**

*Kuadrot e Raportimit Financiar që Përcaktojnë një Minimum Kërkesash për Palët e Lidhura* (Ref: Para. 4)

- A1. Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar që përcakton një minimum kërkesash për palët e lidhura është ai që përkufizon kuptimin e palës së lidhur por që ky përkufizim ka një objekt më të ngushtë se sa përkufizimi i parashikuar në paragrafin 10(b)(ii) të këtij SNA, kështu që kërkesa në kuadër për të raportuar marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura mund të zbatohet për shumë më pak marrëdhënie dhe transaksione të palëve të lidhura.

*Kuadrot e Paraqitjes së Drejtë* (Ref: Para. 4(a))

- A2. Në kontekstin e kuadrit të paraqitjes së drejtë,<sup>15</sup> marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura mund të shkaktojnë që pasqyrat financiare të mos arrijnë paraqitjen e drejtë në qoftë se, për shembull, realiteti ekonomik i këtyre marrëdhënieve dhe transaksioneve nuk pasqyrohet përkatësisht në pasqyrat financiare. Për shembull, paraqitja e drejtë nuk arrihet në qoftë se shitja e një prone nga entiteti për një aksioner që kontrollon entitetin bëhet me një çmim mbi ose nën vlerën e drejtë të tregut dhe që kontabilizohet si një transaksion që përmban fitim ose humbje për

<sup>13</sup> SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi 13.

<sup>14</sup> SNA 230, *Dokumentimi i Auditimit*, paragrafët 8-11 dhe paragrafi A6.

<sup>15</sup> SNA 200, paragrafi 13(a), përkufizon kuptimin e kuadreve të paraqitjes së drejtë dhe të përputhshmërisë.

entitetin kur ai në fakt përbën një kontribut ose shlyerje të kapitalit ose pagesën e dividendit.

*Kuadrot e Përputhshmërisë (Ref: Para. 4(b))*

- A3. Në kontekstin e kuadrit të përputhshmërisë, nëse marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura shkaktojnë që pasqyrat financiare të jenë keqrrëfyese apo jo siç diskutohet në SNA 700 (i rishikuar) varet nga rrethanat e veçanta të angazhimit. Për shembull, edhe në qoftë se mosraportimi i transaksioneve të palëve të lidhura në pasqyrat financiare është në përputhje me kuadrin dhe ligjin apo rregulloret e zbatueshme, pasqyrat financiare mund të jenë keqrrëfyese në qoftë se entiteti gjeneron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tij nga transaksionet me palët e lidhura dhe për këtë fakt nuk jep informacione shtesë. Megjithatë, do të ishte shumë e rrallë që audituesi të merrte në konsideratë pasqyra financiare që janë përgatitur dhe paraqitur në përputhje me një kuadër të përputhshmërisë, të cilat të jenë keqrrëfyese, në qoftë se në përputhje me SNA 210<sup>16</sup> audituesi vendos se kuadri është i pranueshëm.<sup>17</sup>

**Përkufizimi i Palës së Lidhur (Ref: Para. 10(b))**

- A4. Shumë nga kuadret e raportimit financiar diskutojnë konceptet e kontrollit dhe influencës së konsiderueshme. Megjithëse ato i diskutojnë këto koncepte duke përdorur terma të ndryshme, ato në përgjithësi shpjegojnë se:
- Kontrolli është pushteti për të qeverisur politikat financiare dhe operacionale të entitetit për të marrë përfitime nga veprimtaritë e tij; dhe
  - Influenca e konsiderueshme (e cila mund të fitohet nga pronësia e aksioneve, statuti ose marrëveshja) është pushteti për të marrë pjesë në vendimet për politikën financiare dhe operacionale të entitetit, por që nuk ka kontrollin ndaj këtyre politikave.
- A5. Ekzistenca e marrëdhënieve të mëposhtme mund të tregojë praninë e kontrollit apo influencës së konsiderueshme:
- Zotërimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i kapitaleve të veta ose i interesave financiare të tjera në entitet.
  - Zotërimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë nga entiteti i kapitaleve të veta ose interesave financiare të tjera në entitete të tjera.

<sup>16</sup> SNA 210, *Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit*, paragrafi 6(a).

<sup>17</sup> SNA 700 (i rishikuar), paragrafi A17.

- Marrja pjesë në ata që janë ngarkuar me qeverisjen apo në drejtimin e lartë (që janë, ata antarë të drejtimit të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e veprimtarive të entitetit).
- Të qënit pjestar i afërt i familjes të ndonjë personi që i referohet nënparagrafi (c).
- Të pasurit e marrëdhënies së konsiderueshme të biznesit me ndonjë nga personat të referuar në nënparagrafin (c).

*Palët e lidhuar me Influencë Dominuese*

- A6. Palët e lidhura, nga statusi i aftësisë së tyre për të ushtruar kontroll ose influencë të konsiderueshme, mund të jenë në gjendje të ushtrojnë influencë dominuese ndaj entitetit apo drejtimit të tij. Marrja në konsideratë e kësaj sjellje është e rëndësishme kur identifikohen dhe vlerësohen rreziqet për anomali materiale për shkak të mashtrimit, siç shpjegohet më tej në paragrafët A29-A30.

*Entitetet për Qëllime të Posaçme si Palë të Lidhura*

- A7. Në disa rrethana, entiteti për qëllime të posaçme<sup>18</sup> mund të jetë palë e lidhur e entitetit sepse entiteti në thelb e kontrollon atë, edhe në qoftë se entiteti zotëron pak ose aspak pjesë në kapitalin e entitetit për qëllime të posaçme.

**Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Veprimtaritë Përkatëse**

*Rreziqet për Anomali Materiale që Shoqërojnë Marrëdhëniet dhe Transaksionet e Palëve të Lidhura (Ref: Para. 11)*

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

- A8. Përgjegjësitë e audituesit të sektorit publik në lidhje me marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura ndikohen nga mandati i auditimit, ose nga detyrimet ndaj entiteteve të sektorit publik që parashikohen me ligj, rregullore ose ndonjë autoritet tjetër. Si rrjedhim, përgjegjësitë e audituesit të sektorit publik mund të mos kufizohen vetëm me trajtimin e rreziqeve për anomali materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura, por gjithashtu mund të përfshijnë përgjegjësi më të gjera për të trajtuar rreziqet e mospërputhjes me ligjin, rregulloret ose ndonjë autoritet tjetër që qeverisin organet e sektorit publik që parashitrojnë kërkesa të veçanta në kryerjen e biznesit me palët e lidhura. Më tej, audituesi i sektorit publik duhet të marrë në konsideratë kërkesat e raportimit financiar për sektorin publik të marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura të cilat mund të ndryshojnë nga ato në sektorin privat.

<sup>18</sup> SNA 315 (i rishikuar), paragrafët A34-A35, japin udhëzues në lidhje me natyrën e entitetit për qëllime të posaçme.

*Njohja e Marrëdhënieve dhe Transaksioneve të Palëve të Lidhura të Entitetit*

Diskutimi në Ekipin e Angazhimit (Ref: Para. 12)

- A9. Çështjet që mund të trajtohen në diskutimin mes pjesëtarëve të ekipit të angazhimit përfshijnë:
- Natyra dhe shtrirja e marrëdhënieve dhe transaksioneve me palët e lidhurat të entitetit (duke përdorur, për shembull, regjistrimin e audituesit të palëve të lidhura të identifikuar të përditësuara mbas secilit auditim).
  - Theksimin e rëndësisë së ruajtjes së skepticizimit profesional përgjatë gjithë auditimit në lidhje me mundësinë e anomalive materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura.
  - Rrethanat apo kushtet e entitetit që mund të tregojnë ekzistencën e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura të cilat drejtimi nuk i ka identifikuar apo raportuar tek audituesi (për shembull, ndonjë strukturë organizative komplekse, përdorimin e entiteteve për qëllime të posaçme për transaksione jashtë bilancit, ose sistem të informacionit të papërshtatshëm).
  - Regjistrimet apo dokumentat që mund të tregojnë ekzistencën e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura.
  - Rëndësinë që drejtimi dhe ata që janë ngarkuar me qeverisjen i japin identifikimit, kontabilizimit të duhur dhe raportimit të marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura (në qoftë se kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton kërkesa për palët e lidhura), si dhe rreziku që shoqëron anashkalimin nga drejtimi të kontrolleve përkatëse.
- A10. Më tej, diskutimi në kontekstin e mashtrimit duhet të përfshijë konsiderata të veçanta se si mund të jenë përfshirë në mashtrim palët e lidhura. Për shembull:
- Se si entitetet për qëllime të posaçme të kontrolluara nga drejtimi mund të përdoren për të mundësuar marrjen e përfitimeve nga drejtimi.
  - Se si mundësohen transaksionet mes entitetit dhe një ortaku biznesi të njohur të një pjestari kryesor të drejtimit për të bërë të mundur keqpërdorimin e aktiveve të entitetit.

Identiteti i Palëve të Lidhura të Entitetit (Ref: Para. 13(a))

- A11. Kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton kërkesa për palët e lidhura, informacioni në lidhje me identitetin e palëve të lidhura me entitetin duhet të jetë menjëherë i disponueshëm nga drejtimi sepse sistemet e informacionit të entitetit

duhet të rregjistrojnë, përpunojnë dhe përmbledhin marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura për të plotësuar kërkesat e kontabilizimit dhe të raportimit sipas kuadrit. Për këtë arsye drejtimi duhet të ketë një listë gjithëpërfshirëse të palëve të lidhura dhe ndryshimeve nga periudha e mëparshme. Për angazhimet që përsëriten, bërja e pyetjeve jep bazat për të krahasuar informacionin e dhënë nga drejtimi me rregjistrimet e audituesit për palët e lidhura të mbajtura shënim në auditimet e mëparshme.

A12. Por kur kuadri nuk përcakton kërkesa për palët e lidhura, entiteti mund të mos ketë instaluar këto sisteme të informacionit. Në këto rrethana, është e mundur që drejtimi nuk ka dijeni për ekzistencën e palëve të lidhura. Pavarësisht nga kjo, kërkesa për të bërë pyetje siç parashikohet në paragrafin 13 përsëri zbatohet sepse drejtimi mund të jetë në dijeni të palëve të cilat plotësojnë përkufizimin e palës së lidhur të parashikuar në këtë SNA. Në një rast të tillë, audituesi bën pyetjet në lidhje me identitetin e palëve të lidhura të entitetit si pjesë të procedurave të vlerësimit të rrezikut të audituesit dhe veprimtaritë përkatëse që kryhen në përputhje me SNA 315 (i rishikuar) për të marrë informacione në lidhje me:

- Strukturat e pronësisë dhe të qeverisjes së entitetit;
- Llojet e investimeve që entiteti është duke bërë dhe planifikon të bëjë; dhe
- Mënyra me të cilën është strukturuar dhe se si është financuar entiteti.

Në rastin e veçantë të marrëdhënies së kontrollit të përbashkët, drejtimi ka të ngjarë që ka dijeni për këto marrëdhënie në qoftë se ato kanë rëndësi ekonomike për entitetin, pyetjet e audituesit ka mundësi të jenë edhe më efektive në qoftë se ato fokusohen në atë që palët me të cilat angazhohet entiteti në transaksione të konsiderueshme, apo shkëmben burimet në gamë të gjerë, janë apo jo palë të lidhura.

A13. Në kontekstin e auditimit të grupit, SNA 600 kërkon që ekipi i angazhimit të grupit t'u japë secilit prej audituesve të entiteteve të kontrolluara një listë të palëve të lidhura të përgatitur nga drejtimi i grupit dhe nga çdo palë tjetër e lidhur për të cilat ka dijeni ekipi i angazhimit të grupit.<sup>19</sup> Kur entiteti është i kontrolluar brenda grupit, ky informacion jep baza të dobishme për pyetjet e audituesit për drejtimin në lidhje me identitetin e palëve të lidhura të entitetit.

A14. Gjithashtu audituesi mund të marrë disa informacione në lidhje me identitetin e palëve të lidhura të entitetit nëpërmjet pyetjes së drejtimin gjatë procesit të pranimit të angazhimit apo të vazhdimit të tij.

<sup>19</sup> SNA 600, *Konsiderata të Veçanta – Auditimi i Pasqyrave Financiare të Grupit (Përfshirë Punën e Audituesit të Entitetit të Kontrolluar)*, paragrafi 40(e).

## Kontrollet e Entitetit ndaj Marrëdhënieve dhe Transaksioneve të Palëve të Lidhura

- A15. Persona të tjerë brenda entitetit konsiderohen se kanë mundësi të kenë njohuri për marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura të entitetit dhe mbi kontrollet e entitetit ndaj këtyre marrëdhënieve dhe transaksioneve. Këta mund të përfshijnë, përderi sa ata nuk janë pjesë e drejtimit:
- Ata që janë ngarkuar me qeverisjen;
  - Personeli që është në gjendje të fillojë, përpunojë, ose rregjistrojë transaksionet që janë edhe të konsiderueshme edhe jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit dhe ata që mbikqyrin apo vëzhgojnë këtë personel;
  - Audituesit e brendshëm;
  - Këshilltarët e brendshëm juridikë; dhe
  - Nëpunësi përgjegjës për etikën ose personi ekuivalent me të.
- A16. Auditimi kryhet mbi premisën se drejtimi dhe, kur është e nevojshme, ata që janë të ngarkuar me qeverisjen kanë pranuar dhe kanë njohur faktin që ata kanë përgjegjësi për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, përfshirë kur është rasti paraqitjen e tyre të drejtë dhe për kontrollin e brendshëm si drejtimit dhe, kur është e nevojshme, ata që janë ngarkuar me qeverisjen të vendosin se çfarë është e nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose qoftë për shkak të gabimit.<sup>20</sup> Përkatësisht, kur kuadri përcakton kërkesa për palët e lidhura, përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi, që me mbikqyrjen e atyre që janë ngarkuar me qeverisjen, të përgatisin, të vënë në zbatim dhe të ruajnë kontrolle të përshtatshme ndaj marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura të tilla që ato të identifikohen dhe të kontabilizohen siç duhet dhe të raportohen në përputhje me kuadrin. Në rolin e tyre të mbikqyrjes, ata që janë ngarkuar me qeverisjen vëzhgojnë se si drejtimi përmbush përgjegjësitë e tij për këto kontrolle. Pavarësisht nga ndonjë kërkesë për palët e lidhura kuadri mund të përcaktojë, se ata që janë ngarkuar me qeverisjen, në rolin e tyre të mbikqyrjes, të marrin informacione nga drejtimi që t'ju mundësojë atyre të njohin natyrën dhe llogjikën e biznesit të marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura të entitetit.
- A17. Për të plotësuar kërkesën e SNA 315 (i rishikuar) për të marrë njohuri të mjedisit të kontrollit,<sup>21</sup> audituesi merr në konsideratë tiparet përkatëse të mjedisit të kontrollit për të zvogëluar rreziqet për anomali materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura, të tilla si:

<sup>20</sup> SNA 200, paragrafi A4.

<sup>21</sup> SNA 315 (i rishikuar), paragrafi 14.

- Kodet e brendëshme të etikës, të komunikuarat përkatësisht personelit të entitetit dhe të vëna në zbatim, që qeverisin rrethanat në të cilat entiteti mund të angazhohet në lloje të veçanta të transaksioneve të palëve të lidhura.
- Politikat dhe procedurat për raportimin e hapur dhe në kohën e duhur të interesave të drejtimit dhe të atyre që janë ngarkuar me qeverisjen që kanë për transaksionet me palët e lidhura.
- Delegimi i përgjegjësive brenda entitetit për identifikimin, rregjistrimin, përmbledhjen dhe raportimin e transaksioneve të palëve të lidhura.
- Raportimi dhe diskutimi në kohën e duhur mes drejtimit dhe atyre që janë ngarkuar me qeverisjen për transaksionet e konsiderueshme të palëve të lidhura jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit, përfshirë edhe nëse ata që janë ngarkuar me qeverisjen kanë vënë në diskutim në mënyrën e duhur llogjikën e biznesit të këtyre transaksioneve (për shembull, duke kërkuar këshillim nga këshilltarë profesionistë të jashtëm).
- Udhëzues të qartë për miratimin e transaksioneve të palëve të treta që përfshijnë konflikt interesi aktual apo të mundshëm, të tilla si miratimi nga një nënkomitet të atyre që janë ngarkuar me qeverisjen që kanë në përbërje idividë të pavarur nga drejtimi.
- Rishikime periodike nga audituesit e brendshëm, kur është e mundur.
- Veprime ndëraktive të ndërmarra nga drejtimi për të zgjidhur çështje të raportimit të transaksioneve të palëve të lidhura, të tilla si duke kërkuar këshillim nga auditues ose këshilltarë juridikë të jashtëm.
- Ekzistenca e politikave dhe procedurave që njoftojnë rreziqet, kur është e mundur.

A18. Kontrollat ndaj marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura brenda disa entiteteve mund të jenë me mangësi ose nuk ekzistojnë fare për një numër arsyesh, të tilla si:

- Drejtimi i konsideron të parëndësishme punët për identifikimin dhe raportimin e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura.
- Mungesa e mbikqyrjes së duhur nga ata që janë ngarkuar me qeverisjen.
- Moskonsiderata e qëllimshme për këto kontrole sepse raportimi i palëve të lidhura mund të zbulojë informacione të cilat drejtimi i konsideron të ndjeshme, për shembull, ekzistenca e transaksioneve që përfshijnë pjestarë të familjes së anëtarëve të drejtimit.



- Njohja e pamjaftueshme nga drejtimi të kërkesave për palët e lidhura të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar.
- Mungesa e kërkesave të raportimit sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar.

Kur këto kontrolle nuk janë efektive ose nuk ekzistojnë, audituesi nuk ka mundësi të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme rreth marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura. Në qoftë se ky është rasti, audituesi duhet, në përputhje me SNA 705 (i rishikuar),<sup>22</sup> të marrë në konsideratë implikimet për auditimin, përfshirë opinionin në raportin e audituesit.

A19. Raportimi financiar me mashtrime shpesh përfshin faktin që drejtimi anashkalon kontrollet që në rast të kundërt duket se veprojnë në mënyrë efektive.<sup>23</sup> Rreziku që drejtimi të anashkalojë kontrollet është më i lartë në qoftë se drejtimi ka marrëdhënie të cilat përmbajnë kontrollin apo influencën e konsiderueshme me palë me të cilat entiteti bën biznes sepse këto marrëdhënie mund të paraqesin për drejtimin nxitës dhe mundësi më të mëdha për mashtrime. Për shembull, interesi financiar i drejtimit me disa palë të lidhura e nxit drejtimin të anashkalojë kontrollet duke (a) drejtuar entitetin kundër interesave të tij, për të bërë transaksione për përfitime të këtyre palëve, ose (b) bërë marrëveshje të fshehta për të kryer transaksione për përfitime të këtyre palëve. Shembujt e mashtrimeve të mundshme përfshijnë:

- Duke krijuar kushte të rreme të transaksioneve me palët e lidhura që përgatiten për të keqparaqitur llogjikën e biznesit të këtyre transaksioneve.
- Duke organizuar në mënyrë mashtruese transferimin e aktiveve nga ose për drejtimin ose të tjerë me shuma konsiderueshëm më të larta ose më të ulta se sa vlera e tregut.
- Duke u angazhuar në transaksione komplekse me palët e lidhura, të tilla si entitetet për qëllime të posaçme, të cilat strukturohen për të keqparaqitur gjendjen financiare ose rezultatin financiar të entitetit.

Konsiderata të veçanta për entitetet më të vogla

A20. Në entitetet më të vogla veprimtaritë e kontrollit ka të ngjarë që të jenë më pak zyrtare dhe entitetet më të vogla nuk kanë procese të dokumentuara për të trajtuar marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura. Një pronar-drejtuës mund të zvogëlojë disa rreziqe që vijnë nga transaksionet e palëve të lidhura, ose ka mundësi që t'i rrisë këto rreziqe. Për të tilla entitete, audituesi duhet të marrë njohuri për marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura dhe çdo kontrolli që ekziston ndaj

<sup>22</sup> SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimi i Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

<sup>23</sup> SNA 240, paragrafi 31 dhe A4.

tyre, duke pyetur drejtimin të kombinuar me procedura të tjera, të tilla si vëzhgimi i mbikqyrjes së drejtimin dhe veprimet e rishikimit dhe inspektimin e dokumentacionit përkatës të disponueshëm.

Autorizimi dhe miratimi i transaksioneve dhe angazhimeve të konsiderueshme (Ref: Para. 14(b))

A21. Autorizimi përfshin dhënien e lejes nga një palë apo disa palë që kanë të drejtën përkatëse (qoftë drejtimi, qoftë ata që janë ngarkuar me qeverisjen ose qoftë aksionerët e entitetit) për llogari të entitetit që ta angazhojnë në transaksione të veçanta në përputhje me kritere të paracaktuara, qofshin ato gjykime apo jo. Miratimi përfshin pranimin nga ato palë të transaksioneve në të cilat është angazhuar entiteti përderisa ato kanë plotësuar kriteret mbi bazën e të cilave është dhënë edhe autorizimi. Shembuj të kontrolleve që entiteti ka vënë në zbatim për të autorizuar dhe për të miratuar transaksionet dhe angazhimet e konsiderueshme me palët e lidhura ose transaksionet dhe angazhimet jashtë rrjedhës normale të biznesit përfshijnë:

- Kontrollat monitoruese për të identifikuar ato transaksione dhe angazhime që janë për t'u autorizuar dhe për t'u miratuar.
- Miratimi i kushteve dhe afateve të transaksioneve dhe angazhimeve nga drejtimi, ata që janë të ngarkuar me qeverisjen ose, kur është rasti, aksionerët.

*Ruajtja e Vigjilencës për Informacione të Palëve të Lidhura kur Rishikohen Rregjistrime apo Dokumente*

Rregjistrime apo Dokumente të Cilat Audituesi Duhet t'i Inspektojë (Ref: Para. 15)

A22. Gjatë auditimit, audituesi duhet të inspektojë rregjistrimet dhe dokumentet që mund të japin informacione rreth marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura, për shembull:

- Konfirmimet e palëve të treta të marra nga audituesi (si shtesë e konfirmimeve të bankës dhe ligjore).
- Deklaratat e entitetit të tatimeve mbi të ardhurat.
- Informacionet e paraqitura nga entiteti tek autoritetet rregullatore.
- Rregjistrat e aksionerëve për të identifikuar aksionerët kryesorë të entitetit.
- Deklaratat për konflikte interesi nga drejtimi dhe ata që janë ngarkuar me qeverisjen.

- Rregjistrimet e investimeve të entitetit dhe të skemave të pensioneve.
- Kontratat dhe marrëveshjet me drejtuesit kryesorë apo me ata që janë ngarkuar me qeverisjen.
- Kontratat dhe angazhimet e konsiderueshme që nuk janë në rrjedhën normale të biznesit të entitetit.
- Faturat dhe korrespondenca të veçanta nga këshilltarët juridikë të entitetit.
- Policat e sigurimit të jetës të paguara nga entiteti.
- Kontratat e konsiderueshme të ri-negociuara gjatë periudhës nga entiteti.
- Raportet e audituesve të brendshëm.
- Dokumentat që shoqërojnë deklaratimet e entitetit për entet rregullatore të letrave me vlerë (për shembull, prospektet).

Angazhimet që tregojnë ekzistencën e marrëdhënieve apo transaksioneve të palëve të lidhura të cilat nuk janë identifikuar ose raportuar më parë (Ref: Para. 15)

A23. Një angazhim përmban një marrëveshje zyrtare ose jo zyrtare mes entitetit dhe një ose më shumë palëve për qëllime të tilla si:

- Për të themeluar një marrëdhënie biznesi nëpërmjet mjeteve apo strukturave përkatëse.
- Për të kryer disa lloje transaksionesh sipas kushteve dhe afateve të veçanta.
- Për të dhënë shërbime të caktuara apo mbështetje financiare.

Shembuj të angazhimeve që mund të tregojnë ekzistencën e marrëdhënieve apo transaksioneve të palëve të lidhura të cilat drejtimi nuk i ka identifikuar apo raportuar më parë tek audituesi përfshijnë:

- Pjesëmarrja në ortakëri të parregjistruara me palë të tjera.
- Marrëveshjet për dhënien e shërbimeve palëve të caktuara sipas kushteve dhe afateve që janë jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit.
- Marrëdhëniet e garantuesit dhe të marrësit të garancisë.

Identifikimi i Transaksioneve të Konsiderueshme Jashtë Rrjedhës Normale të Biznesit (Ref: Para. 16)

- A24. Marrja e informacioneve të mëtejshme rreth transaksioneve të konsiderueshme jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit i mundëson audituesit që të vlerësojë nësa janë të pranishëm apo jo faktorët e rrezikut të mashtrimit, nëse ka të tillë, si dhe kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar përcakton kërkesa për palët e lidhura, për të identifikuar rreziqet për anomali materiale.
- A25. Shembuj të transaksioneve jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit mund të përfshijnë:
- Transaksione komplekse me kapitalin, të tilla si ristrukturime apo blerje kapitali.
  - Transaksione me entitete offshore në juridiksione me legjislacion të dobët për shoqëritë tregtare.
  - Dhënia me qira financiare të ambjenteve ose dhënia e shërbimeve prej drejtimit nga entiteti për një palë tjetër kur në këmbim nuk merret asgjë.
  - Transaksione shitje me zbritje apo çmime shumë të larta dhe të pazakonshme.
  - Transaksionet me angazhime rrethore, për shembull, shitjet me një angazhim për të riblerë.
  - Transaksionet sipas kontratave të cilave u ndryshojnë kushtet para se ato të skadojnë.

Njohja e natyrës së transaksioneve të konsiderueshme jashtë rrjedhës normale të biznesit (Ref: Para. 16(a))

- A26. Inspektimi për natyrën e transaksioneve të konsiderueshme jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit përmban marrjen e njohurive mbi llogjikën e biznesit të transaksioneve dhe kushteve dhe afateve të tyre sipas të cilave është angazhuar entiteti.

Shqyrtimi nëse mund të jenë të përfshira apo jo palët e lidhura (Ref: Para. 16(b))

- A27. Pala e lidhur mund të jetë e përfshirë në transaksione të konsiderueshme jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit jo vetëm duke influencuar drejtpërdrejtë transaksionin në të cilin është palë, por gjithashtu duke influencuar atë tërthorazi nëpërmjet ndërmjetësve. Kjo influencë mund të tregojë praninë e faktorit të rrezikut për mashtrim.

*Shkëmbimi i Informacionit për Palët e Lidhura mes Ekipit të Angazhimit* (Ref: Para. 17)

- A28. Informacionet përkatëse të palëve të lidhura që mund të shkëmbehen mes antarëve të ekipit të angazhimit, për shembull përfshijnë:

- Identitetin e palëve të lidhura të entitetit.
- Natyrën e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura.
- Marrëdhëniet apo transaksionet e veçanta apo komplekse të palëve të lidhura të cilat mund të kërkojnë vëmendje të veçantë në auditim, kryesisht transaksionet në të cilat drejtimi ose ata që janë ngarkuar me qeverisjen janë përfshirë financiarisht.

### **Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalive Materiale që Shoqërojnë Marrëdhëniet dhe Transaksionet e Palëve të Lidhura**

*Faktorët e Rrezikut të Mashtrimit me një Palë të Lidhur me Influencë Dominuese (Ref: Para. 19)*

A29. Dominimi i drejtimit nga një person i vetëm ose një grup i vogël personash pa u kompensuar me kontrolle shtesë është një faktor rreziku për mashtrim.<sup>24</sup> Treguesit e influencës dominuese të ushtruar nga një palë e lidhur përfshijnë:

- Pala e lidhur ka vendosur veton në vendime të konsiderueshme të biznesit të marra nga drejtimi ose ata që janë ngarkuar me qeverisjen.
- Transaksione të konsiderueshme i janë kaluar për miratim përfundimtar palës së lidhur.
- Ka pak ose aspak debate mes drejtimit dhe atyre që janë ngarkuar me qeverisjen në lidhje me propozimet e biznesit të iniciuara nga pala e lidhur.
- Transaksionet që përfshijnë palën e lidhur (ose pjestarë të afërm të familjes së palës së lidhur) rrallë herë janë rishikuar dhe miratuar në mënyrë të pavarur.

Influenca dominuese gjithashtu mund të ekzistojë në disa raste në qoftë se pala e lidhur ka luajtur një rol udhëheqës në themelimin e entitetit dhe vazhdon të luajë një rol udhëheqës në drejtimin e entitetit.

A30. Në praninë e faktorëve të tjerë të rrezikut, ekzistenca e një pale të lidhur me influencë dominuese mund të tregojë rreziqe të konsiderueshme të anomalive materiale për shkak të mashtrimit. Për shembull:

- Një xhiro e lartë e drejtuesve kryesor ose e këshilltarëve profesionistë mund të sygjerojë praktika biznesi jo etike apo mashtrimi të cilat u shërbejnë qëllimeve të palës së lidhur.

---

<sup>24</sup> SNA 240, Shtojca 1.

- Përdorimi i ndërmjetësve të biznesit për transaksionet e konsiderueshme për të cilat nuk duket se ka ndonjë justifikim biznesi të qartë mund të sygjerojnë se pala e lidhur ka ndonjë interes në këto transaksione nëpërmjet kontrollit të këtyre ndërmjetësve për qëllime mashtrimi.
- Evidenca e pjesëmarrjes së tepruar të palës së lidhur në përzgjedhjen e politikave kontabël apo preokupimi për to, ose përcaktimi i çmuarjeve të konsiderueshme mund të sygjerojë mundësinë e raportimit financiar me mashtrime.

**Përgjigja ndaj Rreziqeve të Anomalive Materiale që Shoqërojnë Marrëdhëniet dhe Transaksionet e Palëve të Lidhura (Ref: Para. 20)**

- A31. Natyra, afatet dhe shtrirja e procedurave të mëtejshme të auditimit që audituesi duhet të zgjedhë për t’ju përgjigjur rreziqeve të vlerësuara të anomalive materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura varet nga natyra e këtyre rreziqeve dhe nga rrethanat e entitetit.<sup>25</sup>
- A32. Shembuj të procedurave thelbësore të auditimit të cilat audituesi duhet të kryejë në rastin kur audituesi ka vlerësuar një rrezik të konsiderueshëm të cilin drejtimi nuk e ka llogaritur siç duhet apo nuk e ka raportuar siç duhet për transaksionet e veçanta të palës së lidhur në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (qoftë për shkak të mashtrimit apo për shkak të gabimit) përfshijnë:
- Konfirmimin apo diskutimin e aspekteve të veçanta të transaksioneve me ndërmjetësit të tillë si bankat, firmat juridike, garantuesit, ose agjentët, kur është e mundur dhe kur nuk ndalohet nga ligji, rregulloret apo rregullat e etikës.
  - Konfirmimin e qëllimeve, kushtet ose shumat e veçanta të transaksioneve me palët e lidhura (kjo procedurë auditimi mund të jetë më pak efektive kur audituesi gjykon se entiteti ka mundësi të ndikojë tek palët e lidhura në përgjigjet e tyre për audituesin).
  - Kur mund të zbatohet, leximin e pasqyrave financiare ose të informacioneve të tjera financiare të rëndësishme, në qoftë se janë të disponueshme, të palëve të lidhura për evidencë të kontabilizimit të transaksioneve në sistemin e kontabilitetit të palëve të lidhura.
- A33. Në qoftë se audituesi vlerëson një rrezik të konsiderueshëm të anomalisë materiale për shkak të mashtrimit si rezultat i pranisë së një pale të lidhur me influencë dominuese, audituesi duhet, si shtesë të kërkesave të përgjithshme të SNA 240, të kryejë procedura auditimi të tilla si më poshtë për të marrë njohuri të marrëdhënieve

<sup>25</sup> SNA 330 jep udhëzime të mëtejshme rreth marrjes në konsideratë të natyrës, afateve dhe shtrirjes së procedurave të mëtejshme të auditimit. SNA 240 përcakton kërkesat dhe jep udhëzime rreth përgjigjeve përkatëse ndaj rreziqeve të vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit.

të biznesit që kjo palë e lidhur ka vendosur me entitetin drejtpërdrejtë apo tërthorazi dhe të përcaktojë nevojën për procedura thelbësore auditimi të mëtejshme përkatëse:

- Pyetjen dhe diskutimin me drejtimin dhe ata që janë ngarkuar me qeverisjen.
- Pyetjen e palës së lidhur.
- Inspektimin e kontratave të konsiderueshme me palën e lidhur.
- Kërkimin e prejardhjes përkatëse, të tillë si nëpërmjet Internetit ose bazave të të dhënave të veçanta të infomacionit të jashtëm për bizneset.
- Rishikimin e raporteve lajmëruese të punonjësve kur ato janë mbajtur.

A34. Në varësi të rezultateve të procedurave të vlerësimit të rrezikut të audituesit, audituesi merr në konsideratë marrjen e evidencës së auditimit pa bërë testimin e kontrolleve të entitetit ndaj marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura. Në disa rrethana, nuk është e mundur të merret evidencë auditimi e mjaftueshme vetëm nga procedurat thelbësore të auditimit në lidhje me rreziqet për anomali materiale që shoqërojnë marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të lidhura. Për shembull, kur transaksionet brenda grupit mes entitetit dhe entiteteve të tjera të kontrolluara janë të shumta dhe është iniciuar, rregjistruar, përpunuar apo raportuar një sasi e madhe informacioni në lidhje me këto transaksione në formë elektronike në një sistem të integruar, audituesi mund të përcaktojë se nuk është e mundur të përgatiten procedura thelbësore auditimi efektive që në vetvete të mund të ulin rreziqet për anomali materiale, që shoqërojnë këto transaksione, në një nivel të ulët të pranueshëm. Në këto raste, plotësimi i kërkesave të SNA 330 për të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për efektivitetin operues të kontrolleve përkatëse,<sup>26</sup> kërkon që audituesi të testojë kontrollet e entitetit ndaj plotësisë dhe saktësisë së rregjistrimit të marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të lidhura.

*Identifikimi i Palëve të Lidhura ose i Transaksioneve të Konsiderueshme të Palëve të Lidhura të Pajidentifikuara apo të Raportuara më Parë*

Komunikimi i Informacioneve të Palëve të Lidhura të Sapo Identifikuara Ekipit të Angazhimit (Ref: Para. 22(a))

A35. Komunikimi menjëherë i çdo pale të lidhur të sapo identifikuar pjestarëve të tjerë të ekipit të angazhimit i ndihmon ata të përcaktojnë nëse ky informacion ndikon rezultatet e procedurave të vlerësimit të rrezikut dhe për konkluzionet e arritura që janë kryer tashmë, përfshirë nëse rreziqet e anomalive materiale kanë nevojë të rivlerësohen apo jo.

<sup>26</sup> SNA 330, paragrafi 8(b).

Procedurat Thelbësore që Lidhen me Palët e Lidhura apo Transaksionet e Konsiderueshme të palëve të Lidhura të Identifikuara Rishtas (Ref: Para. 22(c))

- A36. Shembuj të procedurave thelbësore të auditimit që audituesi duhet të kryejë në lidhje me palët e lidhura dhe transaksionet e konsiderueshme të palëve të lidhura të identifikuara rishtas përfshijnë:
- Bërjen e pyetjeve në lidhje me natyrën e marrëdhënieve të entitetit me palët e lidhura të identifikuara rishtas, përfshirë (kur është e përshtatshme dhe nuk është e ndaluar nga ligji, rregulloret apo rregullat etike) duke pyetur palët jashtë entitetit të cilët supozohen se kanë njohuri të konsiderueshme për entitetin dhe biznesin e tij, të tillë si këshilltarët juridikë, ndërmjetësit kryesor, përfaqësuesit kryesor, këshilltarët, garantuesit, ose ortakë të tjerë të ngushtë të biznesit.
  - Kryerja e analizave financiare të rregjistrimeve kontabël për transaksionet me palët e lidhura të identifikuara rishtas. Këto analiza mund të bëhen më lehtë duke shfrytëzuar teknikat e auditimit me ndihmën e kompjuterit.
  - Verifikimin e kushteve dhe afateve të transaksioneve me palët e lidhura të identifikuara rishtas dhe vlerësimin nëse këto transaksione janë kontabilizuar dhe raportuar siç duhet në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Mosraportimi i Qëllimshëm nga Drejtimi (Ref: Para. 22(e))

- A37. Kërkesat dhe udhëzimet e SNA 240 në lidhje me përgjegjësitë e audituesit në lidhje me mashtrimin në auditimin e pasqyrave financiare janë të rëndësishme e përkatëse kur drejtimi duket se ka qëllim të mos raportojë palët e lidhura dhe transaksionet e konsiderueshme të palëve të lidhura tek audituesi. Audituesi gjithashtu duhet të marrë në konsideratë nëse është e nevojshme apo jo të rivlerësojë besueshmërinë e përgjigjeve të drejtimit për pyetjet e audituesit dhe deklarimeve të drejtimit për audituesin.

*Identifikimi i Transaksioneve të Konsiderueshme të Palëve të Lidhura jashtë Rrjedhës Normale të Biznesit të Entitetit*

Vlerësimi i Llogjikës së Biznesit të Transaksioneve të Konsiderueshme të Palëve të Lidhura (Ref: Para. 23)

- A38. Për të vlerësuar llogjikën e biznesit të një transaksioni të konsiderueshëm me palën e lidhur jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit, audituesi duhet të marrë në konsideratë sa më poshtë vijon:
- Nëse transaksioni:



- Është tejet kompleks (për shembull, ai mund të përmbajë shumë palë të lidhura brenda një grupi të konsoliduar).
  - Ka kushte tregtare të pazakonta, të tilla si çmime, përqindje interesi, garanci dhe kushte shlyerje të pazakonta.
  - Nuk ka një arsye të llogjikshme biznesi përse ka ndodhur.
  - Përfshin palë të lidhura të pidentifikuara më parë.
  - Është përpunuar në një mënyrë të pazakonshme.
- Nëse drejtimi ka diskutuar natyrën dhe kontabilizimin e këtyre transaksioneve me ata që janë ngarkuar me qeverisjen.
  - Nëse drejtimi i ka dhënë më shumë rëndësi trajtimit kontabël të veçantë se sa për t'ju dhënë rëndësinë e duhur kushteve ekonomike bazë të transaksioneve.

Në qoftë se shpjegimet e drejtimit janë materialisht të pabazuara në kushtet e transaksionit të palës së lidhur, audituesit i duhet, që në përputhje me SNA 500,<sup>27</sup> të marrë në konsideratë besueshmërinë e shpjegimeve të drejtimit dhe deklarimeve edhe për çështjet e tjera të konsiderueshme.

- A39. Audituesi gjithashtu duhet të njohë llogjikën e biznesit të transaksioneve të tilla nga këndvështrimi i palës së lidhur, sepse kjo do ta ndihmojë më mirë audituesin të njohë realitetin ekonomik të transaksionit dhe përse është kryer ai. Llogjika e biznesit nga këndvështrimi i palës së lidhur që duket se është jo i njëjtë me natyrën e biznesit të tij mund të paraqesë një faktor rreziku për mashtrim.

Autorizimi dhe Miratimi i Transaksioneve të Konsiderueshme të Palëve të Lidhura (Ref: Para. 23(b))

- A40. Autorizimi dhe miratimi nga drejtimi, nga ata që janë ngarkuar me qeverisjen, ose kur është rasti, nga aksionerët i transaksioneve të konsiderueshme të palëve të lidhura jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit mund të japë evidencë auditimi se këto janë trajtuar siç duhet në nivelet përkatëse brenda entitetit dhe se kushtet dhe afatet e tyre janë pasqyruar përkatësisht në pasqyrat financiare. Ekzistenca e transaksioneve të kësaj natyre që nuk kanë qënë subjekt i këtyre autorizimeve dhe miratimit, në mungesë të shpjegimeve të llogjikshme bazuar në diskutimet me drejtimin ose me ata që janë ngarkuar me qeverisjen, mund të tregojë se ka rreziqe të anomalive materiale për shkak të mashtrimit ose të gabimit. Në këto rrethana, audituesi duhet të jetë vigjilent për transaksione të tjera të kësaj natyre. Vetëm autorizimi dhe miratimi, megjithatë, mund të mos jenë të mjaftueshëm për të dalë në

<sup>27</sup> SNA 500, *Evidenca e Auditimit*, paragrafi 11.

konkluzionin që nuk ka rreziqe për anomali materiale për shkak të mashtrimit sepse autorizimi dhe miratimi mund të jenë joefektivë në qoftë se ka marrëveshje të fshehtë mes palëve të lidhura ose në qoftë se entiteti është subjekt i influencës dominuese nga një palë e lidhur.

Konsiderata të veçanta për entitete më të vogla

- A41. Një entitet më i vogël mund të mos ketë disa kontrole që kryhen në nivele të ndryshme të autoritetit dhe miratimit që ekzistojnë në entitetet më të mëdha. Përkatësisht, kur auditohet një entitet më i vogël, audituesi duhet të mbështet në një shkallë më të ulët në autorizimin dhe miratimin për evidencën e auditimit në lidhje me vlefshmërinë e transaksioneve të konsiderueshme të palës së lidhur jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit. Në vend të kësaj, audituesi merr në konsideratë kryerjen e procedurave të tjera të auditimit të tilla si inspektimi i dokumenteve përkatëse, konfirmimin e aspekteve të veçanta të transaksioneve me palët përkatëse, ose vëzhgimin e përfshirjes në transaksionet të pronarit-drejtimesit.

*Pohimet Që Transaksionet e Palës së Lidhur Janë Kryer sipas Kushteve të Njëjta me Ato që Janë Mbizotëruese në Transaksionin Duarlirë (Ref: Para. 24)*

- A42. Megjithëse evidenca e auditimit mund të jetë menjëherë e disponueshme në lidhje me se sa janë të krahasueshme çmimet e transaksionit të palës së lidhur me çmimet e transaksioneve të ngjashme duarlirë, zakonisht ka vështirësi praktike që kufizojnë mundësinë e audituesit për të marrë evidencë auditimi se të gjitha aspektet e tjera të transaksionit janë të njëjta me ato të transaksionit duarlirë. Për shembull, megjithëse audituesi ka mundësi të konfirmojë nëse një transaksion i palës së lidhur është kryer me çmim tregu, mund të jetë e vështirë për të konfirmuar nëse kushtet dhe afatet e tjera të transaksionit (të tilla si kushtet e kreditimit, eventualitetet dhe shpenzimet shtesë) janë të njëjta me ato që zakonisht bien dakord palët e pavarura. Përkatësisht, në këto raste mund të ketë rrezik se pohimet e drejtimit që transaksioni i palës së lidhur është kryer me kushte të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksione duarlirë mund të jenë keqdeklaruar materialisht.
- A43. Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi të paraqesë një pohim që transaksioni i palës së lidhur është kryer me kushtet e njëjta me ato që mbizotërojnë në një transaksion duarlirë. Mbështetja e drejtimit për pohimin mund të përfshijë:
- Krahasimin e kushteve të transaksionit të palës së lidhur me ato të një transaksion identik ose të ngjashëm me një apo më shumë palë të palidhura.
  - Angazhimin e një eksperti të jashtëm për të përcaktuar vlerën e tregut dhe për të konfirmuar kushtet dhe afatet e tregut për transaksionin.
  - Krahasimin e kushteve të transaksionit me kushtet e njohura të tregut për transaksione gjerësisht të ngjashme në një treg të hapur.

A44. Vlerësimi i mbështetjes së drejtimit për këtë pohim duhet të përmbajë një apo më shumë nga faktorët e mëposhtëm:

- Marrja në konsideratë e përshtatshmërisë së procesit të drejtimit për mbështetjen e pohimit.
- Verifikimin e burimeve të të dhënave të brendëshme apo të jashtëme që mbështesin pohimin, si dhe testimin e të dhënave për të përcaktuar saktësinë, plotësinë dhe përkatësinë e tyre.
- Vlerësimin e llogjikës së ndonjë supozimi të rëndësishëm mbi të cilin është bazuar pohimi.

A45. Disa kuadro të raportimit financiar kërkojnë dhënien e informacionit shtesë për transaksionet e palëve të lidhura që nuk janë kryer me kushte të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionet duarlibër. Në këto rrethana, në qoftë se drejtimi nuk ka dhënë informacione shtesë për transaksionin e palës së lidhur në pasqyrat financiare, duhet të ketë një pohim të veçantë se transaksioni është kryer me kushte të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionin duarlibër.

### **Vlerësimi i Kontabilizimit dhe Raportimit të Marrëdhënieve dhe Transaksioneve të Palës së Lidhur të Identifikuar**

*Konsiderata për Materialitetin në Vlerësimin e Keqdeklarimit (Ref: Para. 25)*

A46. SNA 450 kërkon që audituesi të marrë në konsideratë edhe madhësinë edhe natyrën e keqdeklarimit dhe rrethanat e veçanta në të cilat ka ndodhur, kur vlerëson nëse keqdeklarimi është apo jo material.<sup>28</sup> Rëndësia e transaksionit për përdoruesit e pasqyrave financiare nuk mund të varet vetëm nga shuma e rregjistruar e transaksionit por gjithashtu edhe nga faktorët e tjerë të veçantë përkatës, të tillë si natyra e marrëdhënies me palën e lidhur.

*Vlerësimi i Raportimit të Palës së Lidhur (Ref: Para. 25(a))*

A47. Vlerësimi i raportimit të palës së lidhur në kontekstin e kërkesave për dhënien e informacioneve shtesë të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar kuptohet si marrja në konsideratë nëse faktet dhe rrethanat e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palës së lidhur të entitetit janë përmbledhur dhe paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe që ato janë të kuptueshme. Dhënia e informacioneve shtesë për transaksionet e palës së lidhur mund të mos jetë e kuptueshme në qoftë se:

- Llogjika e biznesit dhe efektet e transaksioneve në pasqyrat financiare janë të paqarta ose të keqdeklaruar; ose

<sup>28</sup> SNA 450, *Vlerësimi i Keqdeklarimeve të Identifikuara Gjatë Auditimit*, paragrafi 11(a). Paragrafi A21 i SNA 450 jep udhëzime mbi rrethanat që mund të ndikojnë në vlerësimin e një keqdeklarimi.

- Kushtet kyçe, apo elementë të tjerë të rëndësishëm të transaksioneve të nevojshme për kuptimin e tyre nuk janë raportuar në mënyrë të përshtatshme.

**Deklarimet me Shkrim (Ref: Para. 26)**

A48. Rrethanat në të cilat është e përshtatshme për të marrë deklaramë me shkrim nga ata që janë ngarkuar me qeverisjen përfshijnë:

- Kur ata kanë miratuar transaksione të veçanta të palës së lidhur që (a) ndikojnë materialisht në pasqyrat financiare, ose (b) përfshijnë drejtimin.
- Kur ata kanë bërë deklaramë të veçanta me gojë tek audituesi për hollësi të ndonjë transaksioni të palës së lidhur.
- Kur ata kanë interesa financiare ose interesa të tjera në palët e lidhura ose në transaksionet e palës së lidhur.

A49. Audituesi gjithashtu duhet të marrë deklaramë me shkrim në lidhje me pohime të veçanta që ka bërë drejtimi, të tilla si deklaramë se transaksione të veçanta të palës së lidhur nuk përmbajnë marrëveshje shtesë të paraportuara.

**Komunikimi me Ata që Janë Ngarkuar me Qeverisjen (Ref: Para. 27)**

A50. Komunikimi i çështjeve të rëndësishme që dalin gjatë auditimit<sup>29</sup> në lidhje me palët e lidhura të entitetit ndihmon audituesin të përcaktojë një kuptim të përbashkët me ata që janë ngarkuar me qeverisjen për natyrën dhe zgjidhjet e këtyre çështjeve. Shembuj të çështjeve të rëndësishme të palës së lidhur përfshijnë:

- Mosraportimin (qoftë ky i qëllimshëm apo jo) nga drejtimi për audituesin i palëve të lidhura apo i transaksioneve të konsiderueshme të palëve të lidhura, të cilët mund të paralajmërojnë personat e ngarkuar me qeverisjen për marrëdhënie dhe transaksione të konsiderueshme të palëve të lidhura për të cilat ata nuk kanë marrë më parë dijeni.
- Identifikimin e transaksioneve të konsiderueshme të palës së lidhur të cilat nuk janë autorizuar dhe miratuar siç duhet, që mund të shkaktojnë dyshime për mashtrim.
- Mosmarrveshjet me drejtimin në lidhje me kontabilizimin dhe raportimin e transaksioneve të konsiderueshme të palës së lidhur në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

<sup>29</sup> SNA 230, paragrafi A8, jep udhëzime shtesë mbi natyrën e çështjeve të rëndësishme që dalin gjatë auditimit.

## PALËT E LIDHURA

- Mospërputhshmëria me ligjin ose rregulloret që zbatohen të cilat ndalojnë ose kufizojnë lloje të veçanta të transaksioneve të palës së lidhur.
- Vështirësitë në identifikimin e palës që përfundimisht kontrollon entitetin.